



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.233/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-86724-02-11-2021, me objekt “*Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Rajonal Lezhë*”, me Fond limit: 17,984,553(shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre)Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: “Alstezo” ShA
Lagjia “Kryengritja e Fierit”, Rruga Aulona, Fier

Autoriteti kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.02.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-86724-02-11-2021, me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Rajonal Lezhë”, me Fond limit: 17,984,553 (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre) Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 08.03.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 25.03.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Vilnik Motors SHPK 11,167,450 I kualifikuar
- Alstezo SHA 17,578,850 I kualifikuar

II.4. Në datën 30.03.2021 operatori ekonomik “Alstezo” ShA ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *E kundërshtojmë këtë renditje në klasifikimin e ofertave të bërë nga AK pasi pretendojmë që operatori Vilnik Motors është kualifikuar në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me LPP. Në rastin konkret të këtij prokurimi kemi të bëjmë me dy oferta të cilat janë konsideruar të vlefshme nga KVO ndërkohë që oferta e ofruar nga OE Vilnik Motors është me vlerë të ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur pra si e tillë ajo duhej të vlerësohej nga KVO si oferta anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 të LPP duke analizuar cmimet një për një përkatësisht për të gjitha zërat e riparimit të kërkuar në DT shtojca 1 (Tabela me zërat e riparimit tek Formulari i Ofertës Ekonomike) na rezulton që të gjitha cmimet e ofruara në ofertën e paraqitur nga ky operator për këtë objekt prokurimi janë shumë të ulëta dhe përveç kësaj nuk janë të argumentuara dhe me shpjegime për elementë të vecanta të ofertës sikurse kërkohet në nenin 56 pikat a,b,c,ç. Përfundimisht duke u mbështetur në LPP neni 56 kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik Vilnik Motors pasi oferta e paraqitur prej tij është anomlaisht e ulët dhe nuk është argumentuar për të gjitha zërat e riparimit të kërkuar nga AK në shtojcën 1 të DT.*

II.5. Në datën 06.04.2021 me shkresën nr.656/2 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 12.04.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.771 prot datë 20.04.2021 protokolluar me tonën me nr.591/2 prot datë 22.04.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” ShA për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK me arsyetimin se “*Vilnik Motors është kualifikuar në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me LPP. Në rastin konkret të këtij prokurimi kemi të bëjmë me dy oferta të cilat janë konsideruar të vlefshme nga KVO ndërkohë që oferta e ofruar nga OE Vilnik Motors është me vlerë të ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur pra si e tillë ajo duhej të vlerësohej nga KVO si oferta anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 të LPP duke analizuar çmimet një për një përkatësisht për të gjitha zërat e riparimit të kërkuar në DT shtojca 1 (Tabela me zërat e riparimit tek Formulari i Ofertës Ekonomike) na rezulton që të gjitha çmimet e ofruara në ofertën e paraqitur nga ky operator për këtë objekt prokurimi janë shumë të ulëta dhe përveç kësaj nuk janë të argumentuara dhe me shpjegime për elementë të veçanta të ofertës sikurse kërkohet në nenin 56 pikat a,b,c,ç. Përfundimisht duke u mbështetur në LPP neni 56 kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik Vilnik Motors pasi oferta e paraqitur prej tij është anomalisht e ulët dhe nuk është argumentuar për të gjitha zërat e riparimit të kërkuar nga AK në shtojcën 1 të DT”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “*Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]*”

III.1.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se në datën 19.03.2021 me anë të shkresës nr.608 protokollit autoriteti kontraktor ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK mbi ofertën ekonomike e cila rezulton anomalisht e ulët në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar me përmbajtje si më poshtë:

- *Në mbështetje të nenit 56 të LPP ju njoftojmë se gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga anëtarët e KVO është konstatuar se oferta e paraqitur nga ana juaj rezulton anomlaisht e ulët. Para së të vazhdojmë me procesin e vlerësimit të ofertave ju kërkojmë të paraqisni me shkrim/në rrugë elektronike dhe brenda tre ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës tuaj për: anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ju keni, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ana juaj, zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Po ashtu ju njoftojmë se keni detyrimin të argumentoni dhe të dokumentoni me prova shkresore sqarimet për elementin /elementët e veçanta të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. Autoriteti do di verifikojë këto elementë dhe në bazë të informacionit të paraqitur nga ana juaj mund ta pranojë ose mund ta refuzojë atë nëse pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ana juaj bindet se ajo është e rregullt në të gjithë elementët e saj.*

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresa nr.633 datë 24.03.2021 me lëndë Dërgojmë informacionin mbi ofertën anomalisht të ulët për procedurën e prokurimit me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Rajonal Lezhë”. Bashkëlidhur kësaj shkrese ky informacion me argumentimin si dhe dokumentacionin me provat shkresore për elementët e ofertës të ofertuar nga ana jonë për këtë objekt prokurimi.
Pjesët e këmbimit janë origjinale nga Distributori i Autorizuar në Shqipëri shoqëria Edmondi SHPK.

Totali i ofertës për pjesët origjinale	10491950
Totali i ofertës për shërbimet e ofruara nga shoqëria Vilnik Motors	675500
Oferta ekonomike	11167450

Nga të cilat shoqëria Vilnik Motors kryen shërbimet në total 675500 dhe shpenzime për Blerje për bojë, stuko dhe elemente të tjerë për lyerje mjete janë 21,000 lekë.
Si rrjedhojë fitimi dhe haku i punës janë në vlerën 654,500 lekë.

Totali i shërbimeve Vilnik Motors	675500
Blerje për bojë stuko dhe elemente të tjerë për lyerje mjete	-21000
Fitimi i shoqërisë Vilnik Motors+Hak pune	654500

Shoqëria Vilnik Motors do të furnizohet me pjesët origjinale nga Distributori i Autorizuar Edmondi SHPK . Pjesët për riparimin e mjeteve ofrohen me çmim nga operatori ekonomik Vilnik Motors 10,491,950 lekë. Çmimi i blerjes së tyre në total është 9,797,282.
Si rrjedhojë fitimi dhe haku i punës është 694,668 lekë.

Blerja e pjesëve të këmbimit origjinale	9797282
Fitimi i shoqërisë Vilnik Motors+hak pune	694668
Totali	10491950

Bashkëngjitur do të gjeni të listuar të gjithë zërat përkatës dhe në mënyrë të detajuar për çdo zë të formularit të ofertës.

- Tabelë me zëra shërbimi të cilat kryhen nga shoqëria Vilnik Motors, emërtimi i shërbimit-njësia matëse-vlera e pritshme për dy vite-blerja e pjesëve-fitimi dhe haku-norma e fitimit në %.

- *Tabelë me pjesët origjinale nga Distributori i Autorizuar Edmondi SHPK, emërtimi i shërbimit-njësia matëse-sasitë totale për katër vite -vlera e pritshme për dy vite –cmimi i blerjes së artikujve-fitimi+haku i punës-norma e fitimit në %.*

III.1.5. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të

ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se ligjëvendësi ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta të cilat në çdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rrezik për realizimin me sukses të kontratës me çmimin e ofertuar dhe se në këtë çmim janë të përfshira të gjithë elementët e kostos të nevojshme dhe të detyrueshme për tu mbuluar. Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 56 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastin konkret KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Vilnik Motors” SHPK është i plotë dhe krijon bindjen për realizimin me sukses të kontratës objekt ankimi. Konkretisht operatori ekonomik Vilnik Motors SHPK përveç paraqitjes së deklaratimit narrativ lidhur me përmbushjen e kushteve për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur një përshkrimi të detajuar të kostos në formë tabelare për shërbimet që do të realizohen nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” dhe një analizë gjithashtu të detajuar të kostos së shërbimeve që do të realizohen nga distributori i autorizuar duke krijuar kështu bindjen se operatori ekonomik ka aftësi për të realizuar me sukses shërbimin objekt prokurimi.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që argumenton ofertën anomalisht të ulët, duke krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” SHA nuk qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19 njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SHA për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-86724-02-11-2021, me objekt

“Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Rajonal Lezhë”, me Fond limit: 17,984,553(shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tre)Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 591 Protokoli; Datë 12.04.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri